



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13, 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, nenit 8 të Rregullores MF—NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve, si dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr:

VENDIM
PËR FORMIMIN E KOMISIONIT VLERËSUES

Neni 1
Përbërja

Me këtë Vendim formohet Komisioni vlerësues për shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve për financimin e projekteve/programeve të OJQ-ve Kulturore për bashkorganizimin e festivalit "Lipjani Këndon" të cilat kanë aplikuar sipas Thirrjes publike Nr. 1-400-47928 e datës 01.08.2018, në përbërje si vijon:

1. Selman Jashanica, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, kryesues
2. Bukuriye Zejnullahu- Jashari, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtare
3. Shaban Sylja, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtar
4. Avdullah Troshupa, nga OJQ-të, anëtar
5. Agim Ejupi, ekspert nga shoqëria civile, anëtar
6. Islam Kaleshi, Zyra e Kryetarit të Komunës, anëtar rezerv.

Neni 2
Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit vlerësues

Komisioni do të bëjë shqyrtimin dhe vlerësimin e aplikacioneve të OJQ-ve Kulturore për bashkorganizimin e festivalit "Lipjani Këndon", konform dispozitave të Rregullores MF-NR-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe me të njëjtin do të njoftohet Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport dhe anëtarët e Komisionit Vlerësues.

1Nr. 400 - 53837
Lipjan, më 24.08.2018

KRYETARI I KOMUNËS
Imri Ahmeti